



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 25 maj 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Ndryshimin e Masave
Mbrojtëse për Lejimin e Nxjerrjes së Informacionit për Ekspertin e Vlerësimit të
Dëmit Material**

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtjes së të Akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykses) nxjerr këtë vendim mbi kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për ndryshimin e masave mbrojtëse për lejimin e nxjerrjes së informacionit për ekspertin e vlerësimit të dëmit material.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 15 dhjetor 2021, 11 gusht 2022 dhe 19 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesat e viktimave V01/04, V02/04, V03/04, V04/04, V05/04, V06/04, V07/04 dhe V08/04 për të marrë pjesë në procesin gjyqësor dhe urdhëroi, ndër të tjera, marrjen e masave mbrojtëse për mosnxjerrjen e identiteteve të tyre dhe të dhënave identifikuese të tyre.¹

2. Më 17 maj 2023, Mbrojtësi i Viktimave dorëzoi një kërkesë për ndryshimin e kufizuar të masave mbrojtëse që u janë caktuar viktimave të lartpërmendura. Synimi i kësaj kërkesë ishte udhëzimi i ekspertit për vlerësimin e dëmeve materiale, dr. Stefan Lerc (dr. Lerc), për të bërë përlogaritjen e dëmeve materiale që viktimat pretendojnë të kenë pësuar, dhe si rrjedhojë të përgatisë një raport (Kërkesa).² Për këtë qëllim, Mbrojtësi i Viktimave më tej saktësoi se ai synon t'i japë dr. Lercit informacionin përkatës nga: (i) formularët e kërkesave të viktimave; (ii) deklaratat e dhëna nga viktimat para Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) gjatë procesit gjyqësor; (iii) aktekspertizën e përgatitur nga *Instituut voor*

¹ KSC-BC-2020-04, F00123, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 15 dhjetor 2021, konfidencial, para. 50. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F00123/RED; F00249, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 11 gusht 2022, konfidencial, para. 43. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F00249/RED; F00279, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 19 shtator 2022, konfidencial, para. 43. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F00279/RED.

² KSC-BC-2020-04, F00514, Mbrojtësi i Viktimave, *Vendim për Caktimin e Ekspertit Financiar dhe Përcaktimin e Hapave Proceduralë të Mëtejshëm në lidhje me Procedurën e Zhdëmtimit*, 17 maj 2023, publik, paragrafët 1, 5, 11.

Mensenrechten en Medisch Onderzoek (iMMO); dhe (iv) nga vetë viktimat, siç i është dhënë Mbrojtësit të Viktimave.³ Mbrojtësi i Viktimave shton se viktimat kanë dhënë pëlqimin e tyre për ndryshimin e masave mbrojtëse ekzistuese.⁴

3. Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtësi i Viktimave nuk kanë dorëzuar përgjigje.⁵

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Trupi Gjykses mbështetet në nenet 23(1) dhe 40(2) dhe (6)(f) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 80, 114(1) dhe 116(4)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës.

III. ANALIZË

5. Trupi Gjykses gjykon se nxjerrja për dr. Lercin e informacionit që identifikon viktimat, siç përshkruhet te Kërkesa e bërë nga Mbrojtësi i Viktimave,⁶ nuk përbën rrezik për viktimat sepse ky informacion nxirret në kuadër të një vlerësimi profesional, që kryhet nga një ekspert i pavarur, i cili është angazhuar edhe më herët në çështjet e gjykuara nga DHSK-ja.⁷ Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se viktimat kanë dhënë pëlqimin e tyre për ndryshimin e masave mbrojtëse ekzistuese.⁸ Rrjedhimisht,

³ Kërkesa, para. 6.

⁴ Kërkesa, para. 9.

⁵ Zyra e Prokurorit të Specializuar njoftoi Trupin Gjykses, me anë të postës elektronike, më 19 maj 2023, në orën 16:35, që nuk synon të përgjigjet ndaj Kërkesës; *shih edhe* KSC-BC-2020-04, Trupi Gjykses I, *Urdhri për Shkurtime dhe Afateve në lidhje me Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Ndryshimin e Masave Mbrojtëse (F00514)*, 19 maj 2023, publik.

⁶ Kërkesa, para. 7.

⁷ KSC-BC-2020-05, F00425, Trial Panel I, *Vendim për Caktimin e Ekspertit Financiar dhe Përcaktimin e Hapave Proceduralë të Mëtejshëm në lidhje me Procedurën e Zhdëmtimit*, 1 qershor 2022, publik.

⁸ Kërkesa, para. 9.

Trupi Gjykses vendos të ndryshojë masat mbrojtëse në fjalë duke lejuar që informacioni në lidhje me identitetet e viktimave t'i jepet dr. Lercit, me qëllim që ky i fundit të mund të përgatisë raportin e kërkuar.

6. Për sa i përket informacionit që do t'i jepet dr. Lercit, Trupi Gjykses lejon Mbrojtësin e Viktimave të nxjerrë, mbi bazë konfidenciale, çdo informacion përkatës e sipas nevojës, nga: (i) formularët e kërkesave të viktimave për pjesëmarrje në procesin gjyqësor dhe dokumentet mbështetëse; (ii) transkriptet e dëshmimeve të tyre para DHSK-së, sipas rastit; (iii) aktekspertizën (e pritshme) të iMMO;-së dhe (iv) nga vetë viktimat, që i është dhënë Mbrojtësit të Viktimave. Ashtu siç është parashtruar në Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave,⁹ dr. Lercit nuk do t'i jepen dokumentet e plota, por vetëm informacioni përkatës që del nga ato.

7. Së fundi, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtësin e Viktimave, në zbatim të zotimit të vet,¹⁰ të njoftojë dr. Lercin se i gjithë informacioni që lidhet me viktimat e lartpërmendura, duke përfshirë edhe statusin e tyre si viktimë në këtë proces gjyqësor, është konfidencial dhe trajtohet si i tillë.

IV. VENDIMI

8. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

- a. **MIRATON** Kërkesën sikurse është përcaktuar në këtë vendim; dhe
- b. **URDHËRON** Mbrojtësin e Viktimave të njoftojë dr. Lercin se gjithë informacioni i dhënë në lidhje me viktimat është konfidencial dhe trajtohet si i tillë.

⁹ Kërkesa, para. 7.

¹⁰ Kërkesa, para. 10.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse**

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 25 maj 2023

Hagë,

Holandë.